

STATUTI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR STATKRAFT RENEWABLES ALBANIA SHPK.

NENI 1

EMRI DHE THEMELIMI

- 1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është Statkraft Renewables Albania Shpk. (në vijim referuar si “Shoqëria”).
- 1.2 Shoqëria themelohet sipas Ligjit shqiptar nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar që mbahet nga Qendra Kombëtare e Biznesit në Tiranë, Shqipëri.

NENI 2

SELIA

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr. “Papa Gjon Pali II”, ABA Business Center, Zyra Nr. 1206, Tiranë, Shqipëri
- 2.2 Shoqëria mund të hapë dhe të mbajë degë, zyra dhe/ose të ushtrojë aktivitetet tregtar në vende të tjera, qoftë brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë, me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm.
- 2.3 Këshilli i Administrimit ose Drejtori i Përgjithshëm, nëse autorizohet shprehimisht nga Këshilli i Administrimit, mund të vendosë të ndryshojë selinë e Shoqërisë në çdo kohë dhe të depozitojë vendimin përkatës pranë autoriteteve kompetente shqiptare. Nëse për këtë gjë nevojitet përditësim dhe ndryshim i këtij neni, për qëllime të pasqyrimit të adresës së re të selisë së Shoqërisë, në masën e lejuar nga ligji i zbatueshëm, Këshilli i Administrimit ose Drejtori i Përgjithshëm, nëse ky i fundit është shprehimisht i autorizuar nga Këshilli i Administrimit, gëzon të drejtën dhe është i autorizuar të vijojë me marrjen e vendimit ose nxjerrjen e një deklarate në lidhje me këtë.

NENI 3

KAPITALI

- 3.1 Kapitali fillestar i Shoqërisë është 100,000 euro (një qind mijë euro). Ekuivalentja e kësaj vlere në leke është 12,584,000 (dymbëdhjetë milionë e pesëqind e tetëdhjetëekatër mijë) lekë, e llogaritur sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e themelimit. Kapitali fillestar ndahet në 1 kuotë, me vlerë 12,584,000 (dymbëdhjetë milionë e pesëqind e tetëdhjetëekatër mijë) lekë.
- 3.2 I gjithë kapitali është i nënshkruar nga Ortaku i Vetëm, shoqëria Statkraft Markets B.V., zotëruese e 100% të kapitalit dhe do të shlyhet në para.
- 3.3 Ortaku i Vetëm mund ta paguajë kapitalin me këste, sipas vlerave dhe afateve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Administrimit të miratuar për këtë qëllim. I gjithë kapitali do të paguhet në llogarinë bankare të Shoqërisë.
- 3.4 Kuotat janë të transferueshme dhe mund të transferohen në çdo kohë sipas kushteve të parashikuara në legjislacionin shqiptar.
- 3.5 Përgjegjësia e Ortakut të Vetëm shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapital.

NENI 4

OBJEKTI I AKTIVITETIT

4.1 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është përfshirja në çdo transaksion të ligjshëm dhe/ose angazhimi në aktivitete të ligjshme për qëllime të cilave mund të themelohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me ndryshimet e tyre të herë pas hershme, ku përfshihet pa kufizim sa më poshtë:

- (i) studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike;
- (ii) studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve eolike (me erë) dhe i sistemeve të lidhura me to, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike;
- (iii) studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i hidrocentraleve dhe i sistemeve të lidhura me to, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike;
- (iv) prodhimi, shitja, tregtimi, studimi, përgjithësisht të gjitha shërbimet mbështetëse në fushën e industrisë dhe energjisë;
- (v) pjesëmarrja në tendera të të gjitha llojeve në fushën e industrisë dhe energjisë, qoftë për llogari të vet ose në bashkëpunim me çdo person fizik apo juridik, qoftë shqiptar apo të huaj;
- (vi) aktivitete tregtare në fushën e energjisë dhe industrisë;
- (vii) kryerja e çdo aktiviteti tregtar dhe e çdo veprimi në Shqipëri apo jashtë saj, që ka lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me objektin e mësipërm të Shoqërisë ose që është e nevojshme për promovimin e biznesit të Shoqërisë dhe për arritjen e objektivave të Shoqërisë.

NENI 5

KOHËZGJATJA

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të papërcaktuar.

NENI 6

ORTAKU I VETËM

6.1 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është Statkraft Markets B.V., një shoqëri e themeluar dhe që vepron sipas ligjeve të Hollandës, e regjistruar pranë Dhomës Tregtare të Amsterdemit me nr. të regjistrimit tregtar 33304386, më datë 19.08.1998, me adresë të regjistruar në: Gustav Mahlerpeien 100, 1082 MA, Amsterdam, Hollandë.

6.2 Ortaku i Vetëm, në përputhje me ligjet e Shqipërisë, mund të marrë vendime për çështjet e mëposhtme, përfshirë po pa u kufizuar:

- (a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

- (b) miratimin e ndryshimeve të këtij statuti;
- (c) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit dhe të Drejtorit të Përgjithshëm, dhe përcaktimin e kompetencave të tyre, të ndryshme nga ato të përmendura në këtë statut, si dhe përcaktimin e shpërblimeve të tyre;
- (d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe përcaktimin e shpërblimeve të tyre;
- (e) monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Këshilli i Administrimit dhe Drejtori i Përgjithshëm;
- (f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë, pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, brenda gjashtë muajve nga mbyllja e vitit financiar;
- (g) miratimin e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit, pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse;
- (h) caktimin e përfaqësuesit të Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera ndaj anëtarëve të Këshillit të Administrimit dhe/ose Drejtorit të Përgjithshëm;
- (i) miratimin e ristrukturimit të Shoqërisë, duke përfshirë bashkimin e saj me shoqëri të tjera, ndarjen dhe transformimin e Shoqërisë, si dhe prishjen e Shoqërisë;
- (j) miratimin e vendosjes së barrës mbi kuotat e Shoqërisë;
- (k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

6.3 Ortaku i Vetëm do të thirret dhe do të miratojë vendime në zbatim të procedurës së parashikuar në këtë nen. Këshilli i Administrimit do të njoftojë Ortakun e Vetëm me email ose me mënyra të tjera të njoftimit me shkrim, të paktën 7 (shtatë) ditë para datës në të cilën duhet të merret vendimi. Njoftim duhet të përmbajë, krahas elementëve të kërkuar nga ligji i zbatueshëm, edhe rendin e ditës/përshkrimin e çështjeve për të cilat do të merret vendim, një draft të vendimit të propozuar për miratim dhe dokumentet përkatëse.

6.4 Vendimet e Ortakut të Vetëm, duke përfshirë sidomos ato të përmendura në paragrafin më sipër, do të regjistrohen në regjistrin e vendimeve të Shoqërisë.

NENI 7

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

7.1. Shoqëria administrohet nga Këshilli i Administrimit dhe nga Drejtori i Përgjithshëm.

7.2 Këshilli i Administrimit

7.2.1 Anëtarët e Këshillit të Administrimit caktohen nga Ortaku i Vetëm dhe mund të shkarkohen në çdo kohë me vendim të Ortakut të Vetëm. Këshilli i Administrimit do të përbëhet nga 4 (katër) anëtarë, persona fizikë, pa kufizime për sa i përket shtetësisë. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të përcaktohet në momentin e emërimit të tyre, por në çdo rast, nuk zgjat më shumë se 5 vjet. Pavarësisht këtij kufizimi, kohëzgjatja e mandatit të tyre mund të rinovohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

7.2.2 Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit janë:

- Z. Tron Engebretsen, shtetas norvegjez, lindur në Bergen, Norvegji, më 7.5.1954, mbajtës i pasaportës nr. 31377340, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Administrimit.



- Znj. Wenche Øyno Lund, shtetase norvegjeze, e lindur në Oslo, Norvegji, më 18.4.1962, mbajtëse e pasaportës nr. 30884186, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Anëtares të Këshillit të Administrimit.
- Z. Olav Hølland, shtetas norvegjez, lindur në Ullensaker, Norvegji, më 6.7.1961, mbajtës i pasaportës nr. 29910562, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Anëtarit të Këshillit të Administrimit.
- Z. Tom Kristian Larsen, shtetas norvegjez, lindur në Lørenskog, Norvegji, më 4.4.1966, mbajtës i pasaportës nr. 29626002, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Anëtarit të Këshillit të Administrimit.

7.2.3 Anëtarët e Këshillit të Administrimit do të rimbursohen për shpenzimet që kryejnë në kuadër të ushtrimit të detyrës së tyre. Ortaku i Vetëm mund të vendosë të japë një kompensim vjetor të çfarëdoshëm.

7.2.4 Në rast se ndonjë nga anëtarët e Këshillit të Administrimit jep dorëheqjen, ai ose ajo duhet të njoftojë me shkrim Këshillin e Administrimit. Dorëheqja hyn në fuqi menjëherë vetëm nëse shumica e Këshillit të Administrimit mbetet në detyrë. Në të kundërt, në rast se anëtarët e mbetur të Këshillit të Administrimit nuk përbëjnë shumicën, dorëheqja do të hyjë në fuqi në momentin e emërimit të anëtarëve të rinj.

7.2.5 Pas mbarimit të mandatit të Këshillit të Administrimit, veprimtaria dhe detyrat e këtij Këshilli të Administrimit përfundojnë në momentin e emërimit të anëtarëve të rinj të Këshillit të Administrimit.

7.2.6 Në rast se një apo më shumë anëtarë japin dorëheqjen nga detyra e tyre si anëtar të Këshillit të Administrimit, ai/ajo/ata do të zëvendësohen përkohësisht me vendim të Këshillit të Administrimit. Anëtarët e emëruar në këto rrethana mbeten në detyrë deri në vendimin e radhës të Ortakut të Vetëm.

7.2.7 Kur shumica e anëtarëve jep dorëheqjen nga detyra e tyre si anëtarë të Këshillit të Administrimit, anëtarët e mbetur njoftojnë Ortakun e Vetëm për t'i dhënë mundësinë që të marrë vendim për emërimin e anëtarëve të rinj të Këshillit të Administrimit. Mandati i tyre përfundon në momentin e mbarimit të mandatit të anëtarëve të mbetur.

7.3 Drejtori i Përgjithshëm

7.3.1 Një nga Anëtarët e Këshillit të Administrimit vepron si Drejtor i Përgjithshëm për administrimin e aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë. Mandati i Drejtorit të Përgjithshëm zgjat për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rinovimi.

7.3.2 Drejtori i Përgjithshëm do të emërohet nga Ortaku i Vetëm dhe mund të shkarkohet në çdo kohë me vendim të Ortakut të Vetëm.

Drejtori i Përgjithshëm i parë i Shoqërisë është Z. Tom Kristian Larsen.

7.4 Rregulla specifike për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Administrimit

7.4.1 Mbledhjet e Këshillit të Administrimit

7.4.1.1 Mbledhjet e Këshillit të Administrimit mbahen në selinë e regjistruar të Shoqërisë në Tiranë, Shqipëri, ose në një vend tjetër të përshtatshëm, sa herë që Drejtori i Përgjithshëm e gjykon të nevojshme, ose kur kërkohet me shkrim nga të paktën dy anëtarë të Këshillit të Administrimit, por jo më pak se 4 herë në vit, në përputhje me nevojat e Shoqërisë. Këshilli i Administrimit mund të marrë vendime edhe me anë të konsultimit me shkrim ose nëpërmjet mjeteve elektronike.

7.4.1.2 Mbledhja thirret me email ose me mënyra të tjera të njoftim me shkresë që mban datën zyrtare, i cili i dërgohet anëtarëve të Këshillit të Administrimit të paktën 7 (shtatë) ditë para mbledhjes. Kur mbledhja është urgjente, njoftimi dërgohet të paktën 3 (tre) ditë përpara datës së mbledhjes.

7.4.1.3 Nuk është e nevojshme të bëhet verifikimi i njoftimit të mbledhjes në rastin kur të gjithë anëtarët janë të pranishëm dhe nuk e kundërshtojnë mënyrën e thirrjes së kësaj mbledhjeje.

7.4.1.4 Kryetari i Këshillit të Administrimit do të jetë dhe kryetari i mbledhjes. Në mungesë të tij/saj, Këshilli i Administrimit do të zgjedhë një kryetar të mbledhjes nga radhët e anëtarëve të tij. Kryetari i mbledhjes ka tagrin të drejtë dhe të organizojë mbledhjen e Këshillit të Administrimit. Kryetari i mbledhjes do të mbajë dhe nënshkruajë procesverbalin e mbledhjes.

7.4.1.5 Vendimet e Këshillit të Administrimit janë të vlefshme kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve. Vendimet merren me miratimin e shumicës së anëtarëve të pranishëm. Në rast se ka barazim votash, vota e Kryetarit të mbledhjes do të jetë vendimtare.

7.4.1.6 Vendimet e Këshillit të Administrimit nënshkruhen nga secili prej anëtarëve të tij. Vendimet regjistrohen në regjistrin përkatës të Shoqërisë.

7.4.1.7 Këshillit të Administrimit ka të drejtën të miratojë çdo akt në lidhje me organizimin e tij të brendshëm, duke përfshirë miratimin e vendimeve me konsultim në formë shkresore ose me mjete elektronike.

7.5 Tagri dhe kompetencat e Këshillit të Administrimit dhe të Drejtorit të Përgjithshëm

7.5.1 Çështjet e mëposhtme janë nën kompetencën ekskluzive të Këshillit të Administrimit (“Çështjet e rezervuara për Këshillin e Administrimit”):

- miratimi i transaksioneve të mëdha me asete dhe/ose aktivitete të Shoqërisë. Përkufizohet si transaksion i madh ai i cili e tejkalon vlerën prej 40.000 Euro;
- marrja e huave në emër të Shoqërisë dhe dhënia e garancive të çdo lloji dhe forme, qoftë hipotekore, barrë siguroese ose lloje të tjera të garancive të vendosura mbi asetet e Shoqërisë në kontekstin e transaksioneve financuese me banka dhe/ose institucione financiare pa kufizime vlerash, me kusht që këto transaksione të jenë në përputhje me strategjitë tregtare dhe me planet e investimit të vendosura nga Ortaku i Vetëm;
- zbatimi i vendimeve të Ortakut të Vetëm;
- garantimi i pajtueshmërisë me ligjet dhe standardet kontabël të Shoqërisë;
- këqyrja dhe verifikimi i librave, dokumenteve dhe aseteve të Shoqërisë;
- i kërkon Ortakut të Vetëm të marrë vendime kur është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë;
- sigurohet që pasqyrat vjetore kontabël dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe raporte e deklarime të tjera të kërkuara nga ligji ose statuti të përgatiten nga Drejtori i Përgjithshëm në mënyrën e duhur. Këto dokumente duhet të miratohen nga Këshilli i Administrimit dhe t'i paraqiten Ortakut të Vetëm për miratim;
- kryen detyra të tjera të parashikuara në ligj dhe në këtë statut;
- mbikëqyr dhe kontrollon aktivitetin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe përmbushjen e detyrave të tij.

7.5.2 Drejtori i Përgjithshëm ka të gjitha ato kompetenca që kanë të bëjnë me administrimin e veprimtarisë së përditshme të Shoqërisë, duke përfshirë pa kufizim sa më poshtë:

- përfaqësimin e Shoqërisë përballë të tretëve;
- veprime me llogaritë bankare të Shoqërisë;

- kryerjen e të gjitha regjistrimeve dhe publikimeve të nevojshme në lidhje me Shoqërinë, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi;
- punësimin dhe shkarkimin e punëmarrësve, sipas politikave të punës të Shoqërisë;
- ndërmarrjen e angazhimeve në emër të Shoqërisë ose kryerjen e transaksioneve me vlerë jo më të madhe se, ose që i shkaktojnë Shoqërisë shpenzime jo më të mëdha se 40.000 Euro, për çdo transaksion. Çdo transaksion përtej këtij kufiri do të miratohet nga Këshilli i Administrimit, përveç rasteve kur është i parashikuar në buxhetin vjetor të miratuar të Shoqërisë;
- sigurohet që librat dhe regjistrat e nevojshëm kontabël të përgatiten dhe të mbahen saktë dhe në mënyrën e duhur;
- kryen veprime/detyra të tjera të caktuara nga Këshilli i Administrimit, me vendim apo prokurë.

7.5.3 Këshilli i Administrimit dhe Drejtori i Përgjithshëm mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat dhe të kryejnë veprimet qoftë personalisht ose përmes personave të tjerë që mund të caktojnë sipas diskrecionit të tyre, përveç atyre që me ligj ose me anë të këtij statuti janë të rezervuara për Ortakun e Vetëm ose janë të kufizuara nga ky statut ose nga ligji i zbatueshëm.

7.6 Përgjegjësia e Këshillit të Administrimit dhe e Drejtorit të Përgjithshëm

7.6.1 Çdo anëtar i i Këshillit të Administrimit që ka interesa, vetjake apo të personave të lidhur me të, në një operacion/transaksion të caktuar, që mund të bien në kundërshtim me ato të Shoqërisë, duhet të njoftojë Këshillin e Administrimit dhe nuk mund të marrë pjesë në vendimet lidhur me atë operacion/transaksion.

7.6.2 Çdo anëtar i i Këshillit të Administrimit i cili, personalisht ose përmes personave të lidhur, sipas përkufizimit në nenin 13 të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ka interesa në marrëveshje që lidhen nga Shoqëria, duhet të njoftojë Këshillin e Administrimit dhe Ortakun e Vetëm. Lidhja e kësaj marrëveshjeje duhet t'i nënshtrohet miratimit nga Ortaku i Vetëm.

7.6.3 Anëtarët e Këshillit të Administrimit ushtrojnë detyrat e tyre të përcaktuara në statut, në legjislacionin e zbatueshëm dhe në vendimet e Ortakut të Vetëm, duke treguar kujdesin e duhur dhe duke mbajtur përgjegjësi solidare ndaj Shoqërisë për dëme që lindin nga shpërdorimi i detyrës prej tyre.

NENI 8

EKSPERTËT KONTABËL

Eksperti(ët) kontabël emërohen me vendim të Ortakut të Vetëm në çdo rast kur është e detyrueshme sipas legjislacionit shqiptar ose kur Ortaku i Vetëm e gjykon të nevojshme.

NENI 9

VITI FINANCIAR

9.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më datë 1 janar dhe përfundon më datë 31 dhjetor.

9.2 Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon pas themelimit të Shoqërisë dhe përfundon më datë 31 dhjetor të po të njëjtit vit.

NENI 10

PRISHJA E SHOQËRISË



10.1 Shoqëria mund të likuidohet me vendim të Ortakut të Vetëm. Kur Shoqëria prishet ajo kalon në likuidim.

10.2 Shoqëria vazhdon si person juridik deri në përfundim të procesit të likuidimit dhe në këtë rast emërtimit të shoqërisë i shtohet shënimi “Shoqëri në likuidim e sipër”.

10.3 Likuiduesi(t) emërohen me vendim të Ortakut të Vetëm. Prishja e Shoqërisë dhe emërimi i likuiduesve duhet të bëhen në përputhje me ligjin shqiptar.

NENI 11

LIGJI I ZBATUESHËM

11.1 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me dispozitat e ligjeve shqiptare.

11.2 Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” do të zbatohet për ato çështje të cilat nuk mbulohen apo nuk parashikohen në këtë statut.

11.3 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e këtij statuti do t'i drejtohet për zgjidhje gjykatave të Republikës së Shqipërisë.

NENI 12

NDRYSHIMET

Ky statut mund të ndryshohet, të rishikohet ose të zëvendësohet me një statut të ri me vendim të Ortakut të Vetëm.

Ky statut hartohet në 3 kopje në anglisht dhe në shqip (në rast mospërputhjeje mes dy versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze) dhe nënshkruhet rregullisht nga Ortaku i Vetëm, sot më datë 25.7.2018, në Tiranë.

ORTAKU I VETËM

STATKRAFT MARKETS B.V.

I përfaqësuar nga z. Tom Kristian Larsen

Tom Kristian Larsen



**BYLAWS
OF THE
LIMITED LIABILITY COMPANY
STATKRAFT RENEWABLES ALBANIA SHPK.**

ARTICLE 1

NAME AND INCORPORATION

- 1.1 The name of the limited liability company is Statkraft Renewables Albania Shpk. (hereafter referred to as the “**Company**”).
- 1.2 The Company is incorporated under Albanian law no. 9901, dated 14.04.2008 “*On Entrepreneurs and Commercial Companies*”, as amended and acquires legal personality after its registration in the Commercial Register kept by the National Business Centre in Tirana, Albania.

ARTICLE 2

REGISTERED OFFICE

- 2.1 The registered office of the Company is at the address: Rr. “Papa Gjon Pali II”, ABA Business Center, Zyra Nr. 1206, Tirana, Albania.
- 2.2 The company may open and maintain branches, offices and/or transact business at other locations, either within or outside the Republic of Albania, upon decision of the Managing Director.
- 2.3 The Board of Directors or the Managing Director, if expressly authorized by Board of Directors, may decide to change the registered office of the Company from time to time and file the respective decision with the Albanian's respective competent authorities. Should this action require an update and amendment of this article for purposes of reflecting the new address of the registered office of the Company, to the extent allowed by the applicable law, the Board of Directors, or the Managing Director, if the latter is expressly authorized from the Board of Directors, are entitled and authorized to proceed with a decision or statement in such regard.

ARTICLE 3

SHARE CAPITAL

- 3.1 The initial share capital of the Company shall be EUR 100,000 (one hundred thousand Euro). The equivalent of this amount in the Albanian currency is Leke 12,584,000 (twelve million and five hundred and eighty-four thousand) calculated in accordance with the official exchange rate of the Bank of Albania on the incorporation date. The initial share capital shall be divided in 1 share, with a value of Leke 12,584,000 (twelve million and five hundred and eighty-four thousand)
- 3.2 The entire share capital is subscribed by the Sole Shareholder, the company Statkraft Markets B.V., owner of 100% of the share capital and will be paid in cash.
- 3.3 The Sole Shareholder may pay the capital in instalments, in the amounts and timeframe indicated in the decision of the Board of Directors adopted for this purpose. The entire share capital will be paid to the bank account of the Company.
- 3.4 The shares are transferable and may be transferred any time under the terms and conditions of the Albanian law.


1

3.5 The Sole Shareholder's liability is extended up to the amount of its contribution in the share capital.

ARTICLE 4

PURPOSE OF ACTIVITY

4.1 The purpose of the Company shall be to transact in any and all lawful business and/or engage in any lawful act or activity for which a limited liability company may be organized under the laws of Albania, as they may be amended from time to time including but not limited to:

- (i) study, design, construction, operation and management of photovoltaic plants and other related facilities for the production of energy from sun power, their repair, technical support and maintenance;
- (ii) study, design, construction, operation and management of wind power plants and other related facilities, their repair, technical support and maintenance;
- (iii) study, design, construction, operation and management of hydropower plants and other related facilities, their repair, technical support and maintenance;
- (iv) production, disposal, trade, supply, generally all support services in the field of industry and energy;
- (v) participation in bids of all kinds in the field of industry and energy on its own or in association with any physical or legal entity, Albanian or foreigner;
- (vi) commercial activities in the field of energy and industry;
- (vii) doing of any business and doing of any action in Albania or abroad that has a direct or indirect relationship with the above purpose of the Company or is necessary for the promotion of the business of the Company and the targets of the Company.

ARTICLE 5

DURATION

The duration of the Company shall be unlimited.

ARTICLE 6

SOLE SHAREHOLDER

6.1 The Sole Shareholder of the Company is Statkraft Markets B.V., a company established and operating under the laws of the Netherlands, registered with the Chamber of Commerce of Amsterdam upon Commercial Register no. 33304386 on 19.08.1998 with the office address at Gustav Mahlerpeien 100, 1082 MA, Amsterdam, the Netherlands.

6.2 The Sole Shareholder in respect of the laws of Albania might take, without being limited to, any of the following decisions:

- (a) setting the business policies of the Company;
- (b) approval of the amendment of the present bylaws;
- (c) appointment and dismissal of the members of the Board of Directors and the Managing Director and determination of their powers other than those mentioned in these bylaws, as well as determination of their remuneration;



2

- (d) appointment and dismissal of liquidator/s and authorized auditor/s and determination of their remuneration;
- (e) monitoring and supervising the implementation of business policies by the Board of Directors and Managing Director;
- (f) approval of the annual financial statements and management reports, after reviewing the relevant documents, within six months of the end of the financial year;
- (g) approval of the capital increase and reduction after reviewing the relevant documents;
- (h) appointment of the representative of the Company in court or other proceedings against members of the Board of Directors and/or Managing Director;
- (i) approval of the restructuring of the Company, including mergers with other companies, division of the Company and transformation of the Company as well as dissolution of the Company;
- (j) approval of lien on shares of the Company;
- (k) other matters set out by law or the bylaws.

6.3 The Sole Shareholder shall be convened and requested to adopt a resolution in pursuance with the procedure provided herein. The Board of Directors shall notify the Sole Shareholder through e-mail or any other written notification means at least 7 (seven) days before the date in which a resolution is required to be adopted. The notification shall indicate among the elements required under the applicable law, also the agenda/description of the matter subject to decision, a draft of the resolution proposed to be adopted and the relevant documents.

6.4 The resolutions of the Sole Shareholder, including in particular those mentioned in the above paragraph, will be registered in a unique resolution register.

ARTICLE 7

MANAGEMENT OF THE COMPANY

7.1. The Company shall be managed by the Board of Directors and the Managing Director.

7.2 Board of Directors

7.2.1 The members of the Board of Directors will be appointed by the Sole Shareholder and may be dismissed at any time upon resolution of the Sole Shareholder. The Board of Directors will be composed of 4 (four) members, natural persons, without any restriction regarding their nationality. The term of the mandate of members of the Board of Directors will be decided at the moment of their appointment, but in any case, may not exceed 5 years. Notwithstanding this limitation, the duration of their mandate may be renewed upon resolution of the Sole Shareholder.

7.2.2 The first members of the Board of Directors are:

- Mr. Tron Engebretsen, Norwegian citizen, born in Bergen, Norway, on 07.05.1954, holder of passport no. 31377340, with full legal capacity to act, as Chairman of the Board.
- Mrs. Wenche Øyno Lund, Norwegian citizen, born in Oslo, Norway, on 18.04.1962, holder of passport no. 30884186 with full legal capacity to act, as Member of the Board.
- Mr Olav Hølland, Norwegian citizen, born in Ullensaker, Norway, on 06.07.1961, holder of passport no. 29910562, with full legal capacity to act, as Member of the Board.
- Mr. Tom Kristian Larsen, Norwegian citizen, born in Lørenskog, Norway, on 04.04.1966, holder of passport no. 29626002, with full legal capacity to act, as Member of the Board.



7.2.3 The members of the Board of Directors shall be reimbursed for expenses they have undertaken due to their duty. The Sole Shareholder may decide to attribute an eventual annual compensation.

7.2.4 In case of resignation of one of the members of the Board of Directors, he or she must notify in writing the Board of Directors. The resignation is of immediate effect only if the majority of the Board of Directors remains in function. Otherwise, in case the remaining members of the Board of Directors would not compose the majority, the resignation enters into force at the moment of appointment of the new directors.

7.2.5 Upon expiration of the mandate of the Board of Directors, the activity and the duties of this Board of Directors terminates at the moment of the appointment of new members of Board Directors.

7.2.6 In case one or more members resign from their office of members of Board of Directors, he/she/they are temporarily substituted upon decision of the Board of Directors. The directors appointed under such circumstances remain in office until the following decision of the Sole Shareholder.

7.2.7 When the majority of members resigns from their office as members of Board of Directors, the remaining members shall notify the Sole Shareholder for enabling the latter to take a decision on the appointment of new members of the Board of Directors. The term of their mandate expires at the moment of expiration of that of the remaining members.

7.3 Managing Director

7.3.1 One of the Members of the Board shall act as the Managing Director for the management of the daily business of the Company. The Managing Director shall be in his office for a period of 5 years, renewable.

7.3.2 The Managing Director will be appointed by the Sole Shareholder and may be dismissed at any time upon resolution of the Sole Shareholder.

The first Managing Director of the company shall be Mr. Tom Kristian Larsen.

7.4 Specific rules to the organization and functioning of the Board of Directors

7.4.1 Meetings of the Board of Directors

7.4.1.1 The meeting of the Board of Directors will take place at the registered office of the Company in Tirana, Albania, or any other suitable place, any time the Managing Director considers it necessary, or when it is requested in writing by at least two members of the Board of Directors, but not less than 4 per year, in compliance with the needs of the Company. The Board may also decide through written consultation or electronic means.

7.4.1.2 The meeting is convened through e-mail or any other notification means bearing an official date, which shall be sent to any member of the Board of Directors at least 7 (seven) days before the meeting. When the meeting is urgent, the notification may be sent at least 3 (three) days before the meeting date.

7.4.1.3 The verification of the meeting notice is not necessary when all the directors are present and do not oppose the conveying of such meeting.

7.4.1.4 The Chairman of the Board of Directors is the chairman of the meeting. In his/her absence, the Board will choose the chairman of the meeting among its members. The Chairman of the meeting will have the power to preside and organize the meeting of the Board. The Chairman of the meeting will keep and sign the minutes of the meeting.

7.4.1.5 The decisions of the Board of Directors are valid when the majority of the members are present. The decisions are taken upon approval of majority of the present directors. In case of a tie vote, the Chairman of the meeting shall have a casting vote.



7.4.1.6 The decisions of the Board of Directors are signed by each of the members. The decisions will be registered in the respective register of the Company.

7.4.1.7 The Board of Directors is entitled to adopt any relevant acts regarding its internal organization, including the passing of resolutions through written consultations or electronic means.

7.5 **Powers and competences of the Board of Directors and Managing Director**

7.5.1 The following matters shall be the exclusive competence of the Board of Directors (“Board of Directors Reserved Matters”):

- approval of large-scale transactions with assets and/or business of the Company. A large-scale transaction is defined as the one exceeding a value of 40,000 Euro;
- borrowing in the name of the Company and giving guarantees of any type and form, whether mortgage, securing charges or other kind of guarantees over company assets in the context of financing transactions with banks, and/or financial institutions without any amount limitation, provided that such a transaction comply with the commercial strategies and investment plans decided by the Sole Shareholder;
- implementation of the decisions of the Sole Shareholder;
- ensuring the compliance of the laws and accounting standards by the Company;
- examination and checking the Company’s books, documents and assets;
- request the Sole Shareholder to adopt a resolution when it is necessary for protecting the interests of the Company;
- ensuring that the annual statement of accounts, business performance, reports and any other disclosures required by the law or bylaws are prepared by the Managing Director in a proper manner. These documents must be approved by the Board of Directors and presented to the Sole Shareholder for approval;
- to carry out other duties as provided in the law and these bylaws;
- supervise and control the activity and performance of the duties by the Managing Director.

7.5.2 The Managing Director will be vested with all those powers that involve the management of daily business of the Company, including but not limited to:

- the representation of the Company against third parties;
- operation with the bank accounts of the Company;
- to perform all mandatory registrations and publications regarding the Company as required under the legislation in force;
- to employ or dismiss employees according to the business policies of the Company;
- enter into commitments on behalf of the Company or perform transactions having a value or involving an expenditure by the Company not exceeding the limit of 40,000 Euro for each transaction. Any transaction beyond such limit shall be approved by the Board of Directors, unless provided for in any approved annual budget of the Company;
- ensure that the necessary accountancy books and records are prepared and maintained in a correct and proper manner;
- other actions/duties conferred to by the Board of Directors, upon resolution or power of attorney.



5

7.5.3 The Board of Directors and the Managing Director may exercise all competences and actions, personally or through other individuals he/she/they may appoint at his/her/their discretion, except for those which by law and these bylaws are reserved to the Sole Shareholder or are restricted by these bylaws or the applicable law.

7.6 Liability of the Board of Directors and Managing Director

7.6.1 Any member of the Board of Directors who has interests, of his own or of related third parties, to an operation/transaction that may be contrary to those of the Company, shall notify the Board of Directors and may not participate in the decisions regarding such operation/transaction.

7.6.2 Any member of the Board of Directors, who personally or through related parties, as defined in Article 13 of Law no 9901, dated 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies", has interests in agreements to be entered by the Company shall notify the Board of Directors and the Sole Shareholder. The conclusion of such agreement should be subject to the approval of the Sole Shareholder.

7.6.3 The members of the Board of Directors shall exercise their duties provided by the bylaws, applicable laws in force and decisions of the Sole Shareholder with due care and they shall be jointly liable towards the Company for damages arising from non-compliance with their duties.

ARTICLE 8

AUDITORS

The auditor(s) shall be appointed by the decision of the Sole Shareholder in any such case when it becomes mandatory by the Albanian Law or when the Sole Shareholder deems it necessary.

ARTICLE 9

ACCOUNTING YEAR

9.1 The fiscal year of the Company shall be from January 1 to December 31.

9.2 By exception, the first financial year begins upon the Company's incorporation and ends on the 31st of December of the same year.

ARTICLE 10

WINDING UP

10.1 The Company may be dissolved by resolution of the Sole Shareholder. Dissolution of the Company shall be followed by winding up.

10.2 The Company will retain its legal personality serving only for liquidation and during liquidation the wording "*under liquidation process*" shall follow the denomination of the Company.

10.3 The liquidator/s shall be appointed upon resolution of the Sole Shareholder. The winding up and the appointment of the liquidator/s shall comply with Albanian law.

ARTICLE 11

APPLICABLE LAW

11.1 The Company shall run its business in full compliance with these bylaws and the provision on Albanian Laws.

11.2 Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies" becomes applicable for those matters that are not covered and provided for by the present bylaws.

6


11.3 Any dispute that may arise concerning the application and interpretation of these bylaws shall be brought for resolution before the courts of the Republic of Albania.

ARTICLE 12

AMENDMENTS

These bylaws may be amended, revised or replaced or new bylaws may be adopted by decision of the Sole Shareholder.

These bylaws are drawn up in 3 copies in English and Albanian language (in case of discrepancies between the two languages, the English version shall prevail) and are duly signed by the Sole Shareholder this day of 25.7.2018, in Tirana.

SOLE SHAREHOLDER

STATKRAFT MARKETS B.V.

Represented by Mr. Tom Kristian Larsen

TOM KRISTIAN LARSEN

